

OPINION: RITJA E CILËSISË SË AUDITIMEVE NË FUNKSION TË PRODUKTIT TË KLSH-së.

nga Shefki JAUPI – Auditues i Lartë¹,

botuar në gazetën “55”, më 08 prill 2014



Standardet e Auditimit janë garantuesit për një auditim të cilësisë së lartë, këto standarde dëshmojnë për ndërgjegjësimin e audituesit të jashtëm për roli dhe përgjegjësinë e tij publike.

Në këtë kuptim një raport auditimi i saktë, i drejtë, i ndershëm dhe i bazuar në parime dhe standarde përgjithësisht të pranuar është sfidë për çdo auditues i ri apo me eksperience, në funksion të misionit dhe vizionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH-së).

Gjatë viteve të fundit vërejmë një progres domethënës në drejtim të rritjes së cilësisë së auditimeve, cilësi e cila ka ardhur nga disa faktorë:

- Njohja e kornizës ligjore të funksionimi të Institucionit: Kushtetues dhe Ligjit Organik të KLSH-së.
- Njohja e Standardeve Ndërkombëtare të auditimit: Standardet e Auditimit të INTOSAI, Udhëzues i Auditimit të Performancës (ISSAI 3000-3100) dhe Udhëzues për Auditimin e Përputhshmërisë (ISSAI 4000 – 4200).
- Njohja e strategjisë së zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2013-2017.
- Njohja e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 53, datë 16.04.2012.

Një nga faktorët kyç që duhet të përmendim është kualifikimi i gjithë stafit auditues nëpërmjet trajnimeve të zhvilluar brenda dhe jashtë vendit, si dhe organizimi i konferencave shkencore të KLSH-së me temë “77 vjet KLSH në 100 vite Shtet Shqiptar” dhe “Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotme”, të cilat do të ndikojë ndjeshëm në cilësinë e misioneve të auditimeve.

Rritja e cilësisë së auditimit është kondicionuar edhe nga forcimi i sistemit të sigurimit të cilësisë.

Kontrolli i sigurimit të cilësisë, si një proces i cili synon të garantojë një përmirësim të vazhdueshëm të punës audituese në zbatim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit, ka qenë dhe mbetet në vazhdimësi një ndër objektivat kryesorë të veprimtarisë së KLSH-së, siç edhe është reflektuar në Planin Strategjik të Zhvillimit, 2013-2017 dhe në programet vjetore të aktivitetit të Institucionit tonë.

Sigurimi i cilësisë, bazuar në standardet kombëtare e ndërkombëtare, është konsideruar si kërkesë e domosdoshme për të identifikuar objektivist mangësitë, përmirësimet që duhen bërë dhe masat efektive që duhen marrë për përmirësimin e punës në të ardhmen, në mënyrë që të sigurohet një cilësi sa më e lartë e punës audituese dhe njëkohësisht t'i shërbejë ligjvënësit, ekzekutivit dhe publikut për t'u njohur me transparencën e përdorimit dhe administrimit të fondeve publike.

Po cilat janë anët e dobëta që ulin performance e angazhimeve/misioneve të auditimit?

Më poshtë po trajtoj anët e dobëta të cilat ndikojnë në cilësinë e auditimeve e për rrjedhojë në produktin e institucionit.

a. Koha për kryerjen e një misioni auditimi është faktori më kyç që ndikon në cilësinë e auditimit, pasi në këtë përfshihen:

- Njohja me subjektin: Afati 10 ditë kalendarike.
- Hartimi i programit të auditimit: Afati 3 ditë pune.
- Puna në terren: Jo më pak se 40 ditë kalendarike.
- Përgatitja e projektraportit të auditimit: Afati deri 15 ditë kalendarike.
- Kthimi nga subjekti i observacioneve/vërejtjeve: Afati 30 ditë kalendarike.
- Ballafaqimet ose verifikimi i shpjegimeve të subjektit të audituar dhe hartimi i Raportit Përfundimtar : Afati deri 15 ditë kalendarike.

Zbatimi në praktikë i këtyre afateve ka vend për përmirësime të vazhdueshme në rregulloren e funksionit të KLSH-së, nga audituesit, përgjegjësit e ekipeve të auditimit dhe krye audituesit.

b. Hartimi i pyetësorëve dhe testeve për punën në terren për çdo fushë/zonë të programit të auditimit nga audituesit, përgjegjësit e grupeve të auditimit dhe krye audituesi, të cilat mund të unifikohen nga strukturat drejtuese të Institucionit për zona të njëjta auditimi. Plotësimi nga subjekti dhe audituesit i pyetësorëve dhe testeve, do të ndikojë në rritjen e cilësisë së auditimit, pasi auditimi mbështetet në një evidencë kompetente.

c. Përmirësime në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në tërësi në mënyrë të veçantë në pjesën: formularët që plotësohen nga grupet e auditimit nga drejtorët e departamenteve të auditimit dhe formularët standard që plotësohen nga departamenti i kërkimit shkencor, zhvillimit dhe teknologjisë së informacionit (statistika), pasi kërkojnë kohë për plotësimin e tyre nga audituesit dhe një pjesë e tyre nuk janë të domosdoshëm për vlerësimin e peformances së Institucionit.

d. Analiza e riskut: Në praktikën e deritanishme rezulton se, përlllogaritja e riskut nuk është e plotë e në disa raste ajo bëhet formale si në nivelin e planifikimit ashtu dhe në hartimit të programeve të auditimit.

e. Mbështetja e stafit auditues për tu bërë sa më të suksesshëm që është e mundur në punën e tyre. Këtu ka vend për angazhime maksimale në procesin auditues nga çdo auditues i ri apo me eksperience.

Në përfundim rritja e cilësisë së misioneve të auditimit për vetë rëndësinë që ka për kuvendin, qeverinë dhe publikun nuk mund të jetë fryt i përpjekjeve të veçara. Kombinimi i kapaciteteve profesionale të Auditimit të Brendshëm në çdo subjekt dhe KLSH, do të krijonte një sinergji e cila do të sillte përmirësime cilësore në auditimet e përputhshmërisë (ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare), financiar dhe peformancës. Ndërkohë që stafet e njëjse të auditimit të entiteteve publike dhe stafi auditues i KLSH-së duhet të marrin përgjegjësit duke u investuar në njohjen, përvetësimin dhe përdorimin e plotë e të saktë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, nëpërmjet programeve të edukimit të vazhdueshëm.

¹ *Shkrime të tjera të botuara nga Shefki JAUPI dhe Mimoza LLOJI për periudhën Janar–Qershor 2014:*

- *Niveli i menaxhimit publik dhe KLSH.*

(Botuar në gazetën “Telegraf”, më 08 maj 2014.)